



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivered	13.01.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	327/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1075/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1075/2022 të datës 01.12.2022, të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me Nr. 10/2022 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.1075/2022 e datës 01.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. ANULOHET Vendimi i datës 08.11.2022 me Nr.10/2022 me numër protokoll 5322/2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III. DETYROHET Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësës si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.

IV. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të kujdeset për zbatim të pikës II dhe III të këtij vendimi.

V.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 10.09.2022 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 12.09.2022 nën shenjën A.nr.792/2022 me numër protokoll 5310/2022, kundër Vendimit me Nr. 05/2022 të datës 12.08.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak të paligjshmërisë së inicimit të procedurës disiplinore, shkelje e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe shkelje e Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.09.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli më datë 29.09.2022, 11.10.2022 dhe 12.10.2022 ka pranuar shkresat që ndërlidhen me objektin e ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.10.2022 ka nxjerrë Vendimin A.nr.792/2022 me numër protokoll 6415/2022 me të cilin ka obliguar Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shfuqizimin e vendimit dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 08.11.2022 ka nxjerrë vendim me NR.10/2022 me të cilin vendim i shqiptohet masa disiplinore ndalim gradimi për periudhën 3 vite.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin e Komisionit Disiplinor me Nr.10/2022 të datës 08.11.2022 i protokolluar me nr.5322/2022 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 01.12.2022 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 7521/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.12.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli më datë 15.12.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokoll 8142/2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7521/2022 të datës 01.12.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr. 10/2022 i datës 08.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Përgjigje në ankesë e datës 15.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokoll 8142/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 23.01.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i nënshkruar me datën 26.01.2022 dhe Vendim i A.nr.792/2022 i datës 24.10.2022 me numër protokoll 6415/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses është e bazuar, **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se Vendimi i datës 08.11.2022 me Nr.10/2022 me numër protokoll 5321/2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmban shkelje të dispozitave procedurale duke pretenduar se vendimi i datës 08.11.2022 me Nr.10/2022 është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik , Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Vendimin A.nr.792/2022 të datës 24.10.2022 me numër protokoll 6415/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka obliguar Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëj shfuqizimin e vendimit dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar në ankesën e ankueses, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në vendimin e tij nuk ka bërë administrimin e provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar. Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të rastit të ankueses nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Nr. 10/2022 i datës 08.11.2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk përmban dispozitiv të qartë, po ashtu edhe arsyetimi është kundërthënës dhe i paqartë siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se :1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.* Ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji,



Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”, e mbi këto baza ligjore të specifikuara më lartë dhe duke pasur parasysh edhe faktin se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkundër që ka pas obligim ligjor nuk ka vepruar konform vërejtjeve të specifikuara në vendimin A.nr.792/2022 të datës 24.10.2022 me numër protokolli 6415/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të eliminimit të të njëjtave, Kolegji ka konstatuar se Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe se gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale sa i përket kësaj çështje që është objekt i kësaj ankese.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazë të arsyetimit si më lartë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar dhe se Vendimi Nr.10/2022 i datës 08.11.2022, me numër protokolli 5321/2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Legjislacionit të Shërbimit Civil dhe me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe se organi kompetentë i punësimit është i obliguar të ndërmarrë veprimet konform dispozitivit të këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1075/2022, datë 13.01.2023


Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;